



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA –BASIC COURT OF GJAKOVA

Në bazë të nenit 27 pika 1 dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 02/2010 për procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës .

Gjykata Themelore Gjakovë

shpall:

K O N K U R S

Nr. 04 /2018

1. Gjykata Themelore në Gjakovë ----- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional -----3 pozita
2. Gjykata Themelore në Gjakovë Dega Rahovec--- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional -----1 pozitë
3. Gjykata Themelore në Gjakovë Dega Malishevë-- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional -----1 pozitë

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita nr: 1-2-3

Titulli i pozitës: Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Gjykata: Gjykata Themelore Gjakovë dhe Degët Rahovec dhe Malishevë

Koeficienti: 9

Nëpunësi mbikëqyrës: Në Gjykatën Themelore Gjakovë - Kryetari i Gjykatës / Në degët Rahovec dhe Malishevë - Gjyqtari Mbikëqyrës

Qëllimi i vendit të punës: Mbështetje profesionale për gjyqtaret dhe ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, duke bërë shqyrtimin e ligjeve, etj..

Detyrat Kryesore

1. Prezanton në seanca gjyqësore të lendeve civile, penale dhe në konteste administrative 20%
2. Ndihmon në raste të tilla duke marrë shënime, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, duke bërë shqyrtimin e ligjeve 20%
3. Ndihmon në përgatitjen e vendimeve gjyqësore (aktgjykimeve, vendime, urdhëresa dhe shkresa tjera.) 20%
4. Ndihmon në përgatitjen e memorandumeve të ndryshme 10%.
5. Angazhohet në procedurat për zgjidhjen alternative të kontesteve gjyqësore 10%
6. Bene hulumtime në shqyrtimin e ligjeve dhe praktikave gjyqësore të dobishme për gjykatën 10%
7. Bene anonimizimin e vendimeve gjyqësore 5%
8. Kryen edhe pune tjera sipas nevojës 5%

Shkathësitë aftësitë e kërkuara:

1. Të ketë shkathësi të dëshmuara nder personale
2. Komunikim të shkëlqyeshëm me shkrim dhe me gojë. E nevojshme
3. Aftësi të kryej hulumtime gjyqësore ----- E nevojshme
4. Njohuri në procedurat e Gjykatave ----- E nevojshme
5. Tre (3) vite përvojë pune në lëmi juridike----- E nevojshme

Kualifikimet arsimorë dhe profesionalë për këtë post:

1. Diplomë të fakultetit juridik ----- E nevojshme
2. Provimin e dhënë të jurisprudencës----- E nevojshme

VREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatët e jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil.
- Kohëzgjatja e emërimit: me kohë të pacaktuar (janë të karrierës)

3.Konkursi është publikuar më dt. 08.05.2018 dhe mbyllet 22.05.2018

Aplikacionet mund t'i merrni në Gjykatën Themelore Gjakovë dhe në Degët Rahovec dhe Malishevë apo përmes faqes <http://www.gjyqesori-rks.org> dhe të dorëzohen në Zyrën e Pranimit.

[Shkarko Aplikacionin](#)

- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

• Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhë të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhurë në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron.

• Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet e nevojshme, për konkurrim, siç janë: Kopja diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, dëshmi e përvojës së punës, certifikatë se nuk udhëhiqet procedurë penale, dy rekomandime. Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiteni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, **ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.**

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.
- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrën e personelit

Nr. Kontaktues:

- Gjykata Themelore Gjakovë
- Rr. "Bardhyl Çausi", Nr.148 Gjakovë
- +381 (0) 390/324-130
- +381 (0) 390/325-423
- gjthgjakove@rks-gov.net

- Dega e Rahovecit
- Rr. "8 Dëshmorët e Pashtrikut" Nr.1, Rahovec.
- Tel. +381 (0) 29-276-224

- Dega e Malishevës

- Rr. “William Wallker” PN, Malishevë
- Tel. +381 (0) 29-269-037